UDHËZIM
Nr. 12, datë 15.3.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT",
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar bëhen ndryshimet e mëposhtme:

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin", bashkëlidhur udhëzimit, zëvendësohet me "Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

"Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat", bashkëlidhur udhëzimit, zëvendësohet me "Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat", që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zzyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD) (Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore	(1) Numri Serial:_____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshëm (NIPT):	**(3)** _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshëm:	**(4)** _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	**(5)** _____
Adresa:	**(6)** _____
Qyteti/Komuna/Rrethi :	
Numri Telefonit:	**(7)** _____

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plote ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet	**Te ushtrimit**	**Tatimore**
(8/9) Te ardhurat	*(8)*	*(9)*
(10/11) Shpenzimet	*(10)*	*(11)*
(12) Shpenzimet e pazbritshme		*(12)*

Rezultati

(13/14) Humbja	*(13)*	*(14)*
(15/16) Fitimi	*(15)*	*(16)*
(17) Humbje e mbartur		*(17)*
(18) Fitimi i tatueshëm neto (16-17)		*(18)*

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 15 %	*(19)*
(20) Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%	*(20)*
(21) Tatim fitimi me përqindje të tjera	*(21)*
(22) Tatim fitimi (19+20+21)	*(22)*
(23) Tatim fitimi i shtyre	*(23)*
(24) Tatim Fitimi i detyrueshëm për t'u paguar	*(24)*

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT

A. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1. **Numri serial** gjenerohet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe shërben për të azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata
2. **Periudha Tatimore** është vjetore
3. **Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT)** është numri i dhënë nga QKR dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve
4. **Emri Tregtar i Personit te Tatueshëm** është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it
5. **Emri, Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar
6. **Adresa** tregohet vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën e NIPT - it
7. **Numri i Telefonit** (nqs ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike

B. TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET

i. Llogaritja e rezultatit

8. **Të ardhurat e ushtrimit** janë të ardhurat totale të periudhës ushtrimore
9. **Të ardhurat tatimore** janë të ardhurat që i përkasin aktivitetit të tatueshëm
10. **Shpenzimet e ushtrimit** janë shpenzimet totale të periudhës ushtrimore
11. **Shpenzimet tatimore** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm
12. **Shpenzimet e pazbritshme** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që nuk njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm

ii. Rezultati

13. **Humbja e ushtrimit** është diferenca e shpenzimeve të ushtrimit (kutia 10) me të ardhurat e ushtrimit (kutia 8) në rast se shpenzimet e ushtrimit janë më të mëdha se të ardhurat e ushtrimit
14. **Humbja tatimore** është diferenca e shpenzimeve tatimore (kutia 11) pasi të zbriten shpenzimet e pazbritshme (kutia12), me të ardhurat tatimore (kutia 9) në rast se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme janë më të mëdha se të ardhurat tatimore
15. **Fitimi i ushtrimit** është diferenca e të ardhurave të ushtrimit (kutia 8) me shpenzimet e ushtrimit (kutia 10) në rast se të ardhurat e ushtrimit janë më të mëdha se shpenzimet e ushtrimit
16. **Fitimi tatimor** është diferenca e të ardhurave tatimore (kutia 9), me shpenzimet tatimore (kutia 11) pasi janë zbritur nga këto të fundit shpenzimet e pazbritshme në rast se të ardhurat tatimore janë më të mëdha se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme.
17. **Humbje e mbartur** është humbja e mbartur nga periudhat paraardhëse dhe që njihet për efekte tatimore për t'u mbuluar nga fitimet e periudhës që deklarohet.
18. **Fitimi i Tatueshëm neto** është fitimi që mbetet nga fitimi tatimor (kutia 16) pasi zbritet humbja e mbartur (kutia 17)

iii. Llogaritja e tatim fitimit

Shënim : Nëse zbatoni dy ose më shumë shkallë tatimore dhe duhet të ndryshoni vlerën e kutive 19, 20, 21, vlerë e cila është e parallogaritur me shkallën tatimore standarte 15 %, atëherë duhet të klikoni kutinë në deklaratë " ■ shënoje këtë kuti për të ndryshuar vlerën e shumës"

19. **Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 15 %** është vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor përkatës, në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar)
20. **Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde 5%** është vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor përkatës, në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" (i ndryshuar)
21. **Tatim fitimi me përqindje të tjera** është shuma e tatimeve të llogaritura me përqindje të tjera (nëse ka) ndaj fitimit të tatueshëm neto sipas ligjeve të tjera të veçanta
22. **Tatim fitimi** është shuma e tatimit të llogaritur me shkallën tatimore standarde 15 % (kutia 19), shuma e tatimit të llogaritur me shkallën tatimore standarde 5% (kutia 20) dhe me Tatim fitimin me përqindje të tjera (kutia 21)
23. **Tatim fitimi i shtyrë** është shuma e llogaritur e tatim fitimit, e cila për shkak të lehtësive tatimore (nëse ka) nuk duhet të paguhet në organet tatimore, por vetëm të rezervohet dhe të paguhet në rast të thyerjes së kushtit për të cilin është përfituar lehtësia tatimore)
24. **Tatim fitimi i detyrueshëm për t'u paguar** është shuma e tatim fitimit t'u detyrueshëm për tu paguar

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT TË MBAJTUR NË BURIM MBI TË ARDHURAT

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):	(3)
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:	(4)
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5)
Adresa:	(6)
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Numri Telefonit:	(7)

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

I. LLOJET E PAGESAVE PËR TË CILAT MBAHET TATIM NË BURIM

		Tatimi në burim
[8] Dividendët	[8] 0	[8/1] 0
[9] Ndarjet e fitimit	[9] 0	[9/1] 0
[10] Interesat	[10] 0	[10/1] 0
[11] Pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale	[11] 0	[11/1] 0
[12] Pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, sherbimet e konsulences, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit	[12] 0	[12/1] 0
[13] Pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues	[13] 0	[13/1] 0
[14] Pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikqyrëse që lidhen me to	[14] 0	[14/1] 0
[15] Pagesat për qiratë	[15] 0	[15/1] 0
[16] Pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose spotistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë, apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre	[16] 0	[16/1] 0
[17] Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë	[17] 0	[17/1] 0
[18] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me shitje	[18] 0	[18/1] 0
[19] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me dhurim	[19] 0	[19/1] 0

II. TATIMI I MBAJTUR NË BURIM

[20] Total tatimi i llogaritur, i mbajtur për t'u paguar {[8/1]+[9/1]+. ..+[19/1]}	[20] 0
[21] TOTALI PËR T'U PAGUAR	[21] 0

, - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

UDHEZUES PËR MENYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TATIMIT TË MBAJTUR NË BURIM MBI TË ARDHURAT

1. **Numri serial [1] gjenerohet nga Drejtoria** Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.
2. **Periudha Tatimore [2] është mujore.**
3. **Rubrika 3 - 7 Gjeneralitete.** Shënoni të dhënat e subjektit siç paraqiten në formular dhe tregoni nëse të dhënat e paraqitura nuk janë **të plota ose kanë ndryshuar.**
4. **Rubrika [8] Dividendët** plotësohet me shumat e pagesave për dividendet që i kryhen aksionerit/ve pas miratimit te rezultatit financiar dhe miratimit të destinimit të fitimit.
5. **Rubrika [9] Ndarjet e fitimit** plotësohen me shumat e pagesave për ndarjet e fitimit që i kryhen ortakut pas miratimit të rezultatit financiar dhe miratimit te destinimit të fitimit.
6. **Rubrika [10] Interesat** plotësohet me shumën e interesave që paguhen gjatë muajit për të cilin deklarohet.
7. **Rubrika [11] Pagesat për të drejtat e autorit dhe pronësinë intelektuale** plotësohet me shumen e pagesave që lindin nga perdorimi apo e drejta per te perdorur te drejtat e autorit dhe pronesine intelektuale.
8. **Rubrika [12] Pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit** plotësohet me pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit.
9. **Rubrika [13] Pagesat për menaxhimin dhe pjesemarrjen në kishillat drejtues** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në keshillat drejtues**.**
10. **Rubrika [14] Pagesat për ndertimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to,** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për ndertimin, instalimin, montimin ose për punë mbikeqyrese që lidhen me to.
11. **Rubrika [15] Pagesat për qiratë** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për qiramarrjen e pasurive të luajtshme/paluajtshme.
12. **Rubrika [16] Pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshire pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artiste ose sportiste, apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre** plotësohet më shumën e pagesave që kryhen për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre.
13. **Rubrika [17] Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë** janë pagesat e përfituara nga individët për fitimin në lojërat e fatit dhe kazinotë.
14. **Rubrika [18] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me shitje** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për kalimin e pronësisë me shitje
15. **Rubrika [19] Pagesat për kalimin e të drejtës së pronësisë me dhurim** plotësohet me shumën e pagesave që kryhen për kalimin e të drejtës së pronësisë me dhurim.
16. **Në rubrikat [8/1] .... deri ne rubriken [19/1]** shënohen shumat e tatimit të mbajtur në burim përkatesisht për pagesat e listuara në rubrikat **[** 8] deri në [19] duke i shumëzuar me % e vlerës së tatueshme. Në rastet kur Republika e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë, % shkallës për llogaritjen e tatimit do të merret sipas përcaktimeve në këto marrëveshje.
17. **Në rubrikën [20] Totali i tatimit të Ilogaritur dhe të mbajtur në burim shënohet shuma e rubrikave** [8/1] + [9/1] + [10/1] + [11/1] + [12/1] + [13/1] + [14/1] + [15/1] + [16/1] + [17/1]+ [18/1]+ [19/1].
18. **Rubrika [21] Totali për t'u paguar** është shuma e tatimit në burim i detyruar për tu paguar i njëjtë me rubrikën 20, pra [20] = [21].